

Letërnjoftimi i Komunës së

# KAMENICËS

# 2014

Maj, 2015





## Fakte


- Të hyrat buxhetore të komunës së Kamenicës më 2014 kanë shënuar rënie në krahasim me një vit më parë.
- Komuna e Kamenicës ka të mbingarkuar me punonjës sektorin publik.
- Në administratë komunale janë të punësuar 226 persona, apo një shërbyes civil për 156 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Kamenica ka edhe së paku 10 të punësuar me kontratë mbi vepër. Këta të punësuar me kontratë mbi vepër janë të angazhuar për periudha mbi një vjeçare.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 798 persona, prej tyre 537 mësimdhënës. Në Komunën e Kamenicës raporti nxënës/mësimdhënës është 12.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 146 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Kamenicës është 241.5. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Kamenica gjatë vitit 2014 ka pasur 2,161 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Kamenicë rreth 7% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Komunën e Kamenicës funksionojnë 687 biznese.
- 111 biznese janë biznese prodhuese, me gjithsejtë 620 punëtorë në sektorin e prodhimit.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 113 biznese të reja.
- Në të njëjtën periudhë, janë shuar 29 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.
- Kryetari i Kamenicës Begzad Sinani gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 20 premtime nga fushat e ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 20%, apo nën mesatare në shkallë vendi, e cila është 24%.

## 2 Qeverisja komunale

Komuna e Kamenicës në zgjedhjet e fundit lokale (2013) ka kaluar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në qeverisjen e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Kryetari aktual i Kamenicës z.Begzad Sinani (PDK) ka fituar mandatin pas balotazhit, i zhvilluar mes tij dhe ish Kryetarit nga radhët e LDK-së z.Shaip Surdulli.


Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 18,843 apo rreth 52% qytetarë me të drejtë vote. Në balotazhin e mbajtur me 1 dhjetor 2013, Begzad Sinani ka marr 55%, ndërsa Shaip Surdulli ka rezultuar me 45%.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave në raundin e parë dhe në balotazh



Zgjedhjet për Kuvendi Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: LDK 8 ulëse, PDK 7 ulëse, AAK dhe AKR me nga katër ulëse, VV dhe PD me nga një ulëse, dhe dy ulëse i ka siguruar 'Iniciativa Qytetare e Kamenicës' subjekt ky i udhëhequr nga komuniteti serb. Pas formimit të Kuvendit komunal ka pasur lëvizje nga një parti në tjetrën në Kamenicë. Aktualisht PDK ka 9 asamblistë, ndërsa AAK një.

Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Kamenicës në bazë të zgjedhjeve 2013




Ekzekutivi komunal i Kamenicës ka 11 drejtori komunale. Pas zgjedhjeve, Kryetari Begzad Sinani ka arritur marrëveshje me AAK dhe AKR për bashkëqeverisjen e komunës.

### 3 Buxheti i Komunës së Kamenicës


Më 2014, Komuna e Kamenicës kishte buxhet prej 8.5 milion eurove, një rritje prej afro 1 milion eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje për 1,166 të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 1.2 milion euro, një rënie e lehtë në krahasim me dy vitet paraprake.

**Grafikoni nr. 3** Buxheti total i Komunës së Kamenicës dhe kategoritë kryesore buxhetore




Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Kamenicës afro 768 mijë euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rënie në krahasim me vitin 2013.

**Grafikoni nr.4** Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Kamenicës 2011-2015




Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë afro 30% të të hyrave të përgjithshme.

**Grafikoni nr.5** Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komonat tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Kamenicës ka arritur të mblodh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komuna si Skenderaj, Malisheva, Deçani, Shtime, etj. ndërsa më pak se sa Vitia, Klina, Istogu, etj.

**Grafikoni nr.6** Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë



Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, telefona mobil, telefona fikse, shpenzime për mëditje jashtë vendit, riparimi i veturave, kanë shënuar rënie të dukshme në krahasim me një vit më parë, ashtu siç mund të shihet nga figura 7.


**Grafikoni nr. 7** Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Instituti GAP

Komuna e Kamenicës gjatë vitit 2014 ka shpenzuar për energji elektrike rreth 140 mijë euro, apo 18 mijë euro me shumë krahasuar me një vit më herët.

**Grafikoni nr. 8** Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve




Instituti GAP

## 4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Kamenica e ka përmbyllur me 1.166 të punësuar në sektorin publik, gjashtë më shumë se sa një vit më parë. Përgjatë këtij viti, janë punësuar tre shërbyes civil më shumë në kuadër të administratës dhe tre punonjës në sektorin e arsimit.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Kamenicës



Kamenica ka të punësuar një shërbyes civil për 156 banorë. Në krahasim me komunitat tjera, Kamenica ka shumë më shumë të punësuar në administratën lokale, në krahasim me popullsinë që ka. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë. Komuna e Kamenicës ka vazhduar të rrit numrin e të punësuarve në sektorin publik, përkundër asaj se nga territori i kësaj komune është shkëputur një pjesë prej nga është krijuar Komuna e Ranilugut.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori






Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Kamenica ka edhe së paku 10 të punësuar me kontratë mbi vepër. Këta të punësuar me kontratë mbi vepër janë të angazhuar për periudhë mbi një vjeçare. Të angazhuarit me kontratë mbi vepër janë kryesisht ish-drejtor komunal, të cilët janë angazhuar në pozita të cilat nuk ekzistojnë në komunat tjera – zëvendës drejtor komunal.

Grafikoni nr.11 Të punësuar me kontratë mbi vepër




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 798 persona, prej tyre 537 mësimdhënës. Në Komunën e Kamenicës raporti nxënës/mësimdhënës është 12.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9. Edhe në sektorin e arsimit, ashtu sikurse në shërbimin civil, Kamenica ka të punësuar më shumë staf se sa mesatarja në shkallë vendi.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Kamenicës



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 146 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Kamenicës është 241.5. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



## 5 Ekonomia lokale

Në Komunën e Kamenicës funksionojnë 687 biznese. 111 biznese janë biznese prodhuese, me gjithsetë 620 punëtorë në sektorin e prodhimit. Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 113 biznese të reja, një numër më i madh se sa që ishin regjistruar në dy vitet paraprake. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.


Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Instituti GAP

Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 29 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.

**Grafikoni nr.15** Llojet e bizneseve të shuara më 2014



Në përgjithësi, Kamenica radhitet ndër komunat me probleme të mëdha ekonomike, për shkak të papunësisë së lartë dhe ambientit jo të favorshëm të të bërit biznes.

## 6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Begzad Sinani gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 20 premtimet e monitoruara, del se deri në maj 2015 z. Sinani ka arritur të realizoj 20% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

**Grafikoni nr.16** Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





**Instituti GAP**

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2  
+381 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)  
[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)  
[www.komunat.institutigap.org](http://www.komunat.institutigap.org)

